



**Republika e Kosovës**  
**Qeveria - Vlada – Government**



***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine -Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

***Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister***

01 Ref. 55

Datë: 18.11.2021

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafit 4 dhe nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 7 paragrafi 3, dhe nenit 9 të Ligji Nr. 06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe, si dhe nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 dhe Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

**V E N D I M**

**PËR HAPJE TË HETIMEVE ZYRTARE PËR MASAT MBROJTËSE NË IMPORTE**

1. Miratohet rekomandimi i Departamentit të Tregtisë për hapjen e hetimeve zyrtare për importin e produkteve konditorike, ëmbëlsirave dhe biskotave të importuara nga Serbia sipas Kodit në TARIK H.S. 19 05.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Bazuar në nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit për Masat Mbrojtëse në Importe, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pas rekomandimit të Departamentit të Tregtisë dhe pas konsultimeve me Komisionin për Vlerësimin e Masave Mbrojtëse në Importe, inicion hetimin për importimin e produkteve konditorike, ëmbëlsirave dhe biskotave të importuara nga Serbia sipas Kodit në TARIK H.S. 19 05. pasi në bazë të analizave preliminare statistikore, produktet e importuara në territorin e Republikës së Kosovës janë në sasi të

rritur dhe në kushte të tilla po i shkaktojnë ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dëm serioz prodhuesve të produkteve të ngjashme ose konkurruese në Republikën e Kosovës.

Statistikat tregojnë se ka një rritje të importit të këtyre produkteve të importuara nga Serbia krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve të kaluara. Gjatë nëntëmujorit të vitit 2021 importi i këtyre produkteve përbën 29% të importit total; krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, është shënuar një rritje prej 10%. Ndërsa eksporti i Kosovës në Serbi për të njëjtën periudhë kohore gjatë vitit 2020 dhe 2021 është vetëm 1% nga eksporti total i këtyre produkteve nga Kosova.



**Rozeta HAJDARI**

*Rozeta Hajdari*  
**Ministre e Ministrisë së Industrisë,  
Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**

Vendimi i dërgohet:

- Dogana e Kosovës;
- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/MINT;
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Masave Mbrojtëse në Importe;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.